



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

RAPORT

**Për veprimtarinë e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe
Parashtresa (PZAP)**

01 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2012

Prishtinë, Janar 2013

Rr. "Luan Haradinaj" Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati i -I-. 10 000 Prishtinë
info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org, [038 211-242](tel:038211242)

P Ë R M B A J T J A

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) – Hyrja.....	2
Misioni i PZAP-it.....	2
Struktura organizative dhe burimet njerëzore të PZAP-it.....	3
Përbërja e panelit të PZAP-it.....	3
Mënyra se si përbëhet një panel i PZAP-it.....	3
Funksionet, përgjegjësit dhe përbërja e Sekretariatit të PZAP-it.....	4
Organogrami.....	6
Aktivitetet e PZAP-it dhe të Sekretariatit.....	7
Akt emërimet e shërbyesve civil dhe vlerësimet e punës për personelin e Sekretariatit të PZAP-it.....	8
Zyra Ligjore.....	9
Përkthimi i dokumenteve dhe qasja në informatat zyrtare.....	10
Komisionet e përhershme të PZAP-it.....	10
Komisionet e përkohshme të PZAP-it.....	11
Punëtorit e PZAP-it të mbajtura në vitin 2012.....	11
Pjesëmarrja e anëtarëve të PZAP-it dhe personelit të Sekretariatit të PZAP-it në vizita dhe grupe punuese në vend dhe jashtë vendit.....	12
Vizita në Finlandë.....	12
Vizita në Austri.....	12
Shpenzimet vjetore për vitin fiskal 2012.....	13
Ndarjet buxhetore.....	13
Buxheti i planifikuar për vitin 2012.....	13
Buxheti i aprovuar i PZAP – 2012.....	13
Struktura e buxhetit për vitin 2012.....	14
Buxheti i shpenzuar për vitin 2012.....	14
Pagat dhe mëditjet.....	15
Mallra dhe shërbime.....	15

Shpenzimet komunale.....	16
Pjesa përmbyllëse e raportit të shpenzimeve.....	16
Të hyrat e PZAP-it.....	17
Aktivitetet e prokurimit për vitin 2012.....	20
Bashkëpunimi i PZAP-it me institucionet vendore dhe ndërkombëtare	20
Përmbledhje ekzekutive dhe statistika për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Ferizaj dhe Kaçanik.....	22
Natyra e ankesave të paraqitura në PZAP gjatë procesit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunën e Ferizajt.....	23
Rastet e dorëzuara në Prokurorinë e Shtetit.....	29
Paditë e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme për Zgjedhjet ne Ferizaj	30
Sanksionet : Gjjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Ferizaj.....	30
Natyra e ankesave të paraqitura në PZAP gjatë procesit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunën e Kaçanikut.....	32
Rastet e dorëzuara në Prokurorinë e Shtetit.....	34
Paditë e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme për zgjedhjet ne Kaçanik.....	34
Sanksionet:Gjjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike.....	35
Komunikimi i PZAP-it me Gjykata te ndryshme në për Kosovë gjatë vitit 2012.....	36

I. Hyrje

Raporti i Institucionit të PZAP-it për vitin 2012, është një rezultat i përpjekjeve të bëra në vite prej themelimit nga stafi i Institucionit të PZAP-it. Ky raport, me ndryshimet strukturore të tij, reflekton në të njëjtën kohë edhe ndryshimet që kanë ndodhur në fushën e vendosjes së ankesave dhe apeleve të lejuara gjatë proceseve Zgjedhore të mbajtura në vitin 2012 nga ana e PZAP-it.

Raporti i Institucionit të PZAP-it për vitin 2012, është një detyrim ligjor për këtë institucion. Në të njëjtën kohë, është një përgjegjësi e institucionit të japë një paraqitje të pranueshme të gjetjeve, respektivisht të arriturave gjatë një viti kalendarik.

II. Prezantim i shkurtër i strukturës së Raportit Vjetor 2012

Raporti Vjetor është instrumenti i rëndësishëm i Institucionit të PZAP-it, nëpërmjet të cilit bëhet e mundur njohja e anëtarëve të Kuvendit dhe opinionit publik me punën e PZAP-it, gjatë vitit për të cilin bëhet raportimi. Ky është raporti i tretë vjetorë i veprimtarisë së Institucionit të PZAP-it, i cili në ndryshim nga raportimet e mëparshme, përmban një analizë të veprimtarisë së Institucionit, të ndarë sipas mandatit të PZAP-it, të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

1. PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)

1.1 Hyrja

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i ushtron funksionet dhe përgjegjësit e tij sipas nenit 115 të Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr. 03 / L-072).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me ligjin dhe rregullat zgjedhore.

PZAP, zbaton me përgjegjësi Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073, Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr 03 / L-072), Rregullat Zgjedhore, Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe Rregullën Nr. 01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave.

1.2 Misioni

Misioni i PZAP-it, është mbrojtja e të drejtave zgjedhore, respektivisht Zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare, si për nivelin qendror ashtu edhe për nivelin lokal.

2. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT

Siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me vendimin Agj.nr. 685/2010 të datës 08.11.2010, anëtarët e PZAP-it, duke përfshirë këtu edhe kryetarin e PZAP-it, janë emëruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

2.1 Përbërja e panelit të PZAP-it

1. Shukri Sylejmani, Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryetar i PZAP- it
2. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës së Qarkut – Prizren, anëtarë,
3. Muharrem Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Pejë, anëtarë,
4. Hasan Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Pejë, anëtarë,
5. Xhevdet Abazi, Kryetar i Gjykatës së Qarkut – Mitrovicë, anëtarë,
6. Ferit Osmani, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Mitrovicë, anëtarë,
7. Nehat Idrizi, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Prishtinë, anëtarë,
8. Rafet Haxhaj, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Prishtinë, anëtarë,
9. Muhamet Rexha, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Gjilan, anëtarë,
10. Vlastimir Dimić, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Gjilan, anëtarë.

Për shkak të dorëheqjes së gjyqtarit Vlastimir Dimić nga Sistemi Gjyqësor i Kosovës, i cili ka qenë Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe anëtarë i PZAP-it dhe aprovimit të dorëheqjes së tij nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) më datë 02.11.2012, Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 115 par. 2 të LZP-së, me vendimin Agj.nr.539/12 të datës 09.11.2012, e ka zëvendësuar gjyqtarin e lartcekur me gjyqtarin Nenad Lazić, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si anëtarë të PZAP-it.

2.2 Mënyra se si përbëhet një panel i PZAP-it

PZAP-i përbëhet prej 10 (dhjetë) anëtarëve përfshirë këtu edhe kryesuesin dhe mund të mbledhet në panele prej së paku 3 (tre) anëtarëve.

Anëtarët e emëruar të PZAP-it sipas LZP-së, gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtarë të PZAP-it.

Për çdo panel caktohet një kryesues i panelit për seancën e caktuar. Kryetari i Panelit të PZAP-it cakton përbërjen e paneleve.

3. FUNKSIONET, PËRGJEGJËSIT DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË

PZAP-it

Duke u bazuar në nenin 123 të LZP-së PZAP-i, në ushtrimin e përgjegjësisë dhe funksioneve të tij ndihmohet nga Sekretariati.

Sekretariati i PZAP-it:

- pranon ankesa dhe apele gjatë proceseve zgjedhore;
- arkivon të gjitha shkresat që parashtrihen në PZAP;
- Drafton/harton vendime të ndryshme;
- Me autorizim të panelit heton/mbledh fakte për vendosjen e ankesave të parashtruara në PZAP;
- Harton raporte për rezultatin e hetimeve;
- Përgatit rastet që supozohen se kanë elemente të veprës penale dhe i dorëzon në Prokurorinë Shtetërore të Republikës së Kosovës;
- Ofron ndihmën e nevojshme organeve të drejtësisë për të hetuar rastet me elemente të veprës penale;
- Menaxhon dhe ekzekuton buxhetin vjetor;
- Përkthen vendimet në të gjitha gjuhët sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës;
- Mirëmban adresë zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë.

Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it nën udhëheqjen e Kryetarit të PZAP-it, është përgjegjës për:

- Të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it;
- Përgatitjen e paneleve të PZAP-it duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- Organizimin e Sekretariatit dhe zhvillimin e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionimin e PZAP-it.


- Menaxhon buxhetin vjetor të ndarë nga Buxheti i Republikës së Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e PZAP-it, duke u bazuar në propozim buxhetin e dorëzuar nga Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it.

Me buxhetin e propozuar për vitin 2012 dhe i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i nuk ka pasur ndryshime nga viti paraprak sa i përket numrit të aprovuar të stafit, respektivisht i ka të lejuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryetar të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtarë të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të administratës.

Marrëdhënia e punës se personelit të sekretariatit të PZAP-it, rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13 maj 2010.

Sekretariati i PZAP-it, ka këtë strukturë të brendshme të organizimit: Kryesuesin e Sekretariatit i cili është ekuivalent me pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë, Udhëheqësin e Zyrës Ligjore të Sekretariatit, ekuivalent me pozitën e Drejtorit të Departamentit, Zyrtarin Kryesor Financiar, ekuivalent me pozitën e Drejtorit të Departamentit, tre Zyrtarë të Lartë Ligjorë, Koordinatorin e Përkthimeve Shqip-Serbisht dhe anasjelltas, Zyrtarin për Teknologji Informative dhe Logjistikë, Asistentin Ekzekutiv dhe Zyrtarin e Transportit.

3.1 Organogrami



3.2 Aktivitetet e PZAP-it dhe te sekretariatit

PZAP-i, në zbatim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim të përmbushjes së funksioneve dhe përgjegjësive të tij të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës, në fillim të vitit ka përgatitur dhe miratuar një planë të punës në të cilin planë janë paraqitur dhe përfshirë objektivat e Institucionit të PZAP-it për vitin 2012. Në këtë planë vjetor për shkak të natyrës së mandatit të Institucionit të PZAP-it, detyrave dhe punëve që mundë të këtë gjatë një viti, përveç paraqitjes së objektivave të rregullta ka paraparë edhe objektiva alternative, siç janë: Zgjedhjet e Jashtëzakonshme të mundshme për nivelin qendror apo lokal.

PZAP-i, të gjitha objektivat e parapara në planin e punës i ka përmbushur si në aspektin kualitativ ashtu edhe në atë kuantitativ. Kryerja me sukses e dy proceseve të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Ferizajt dhe Kaçanikut, ka qenë një prej aktiviteteve kryesore të parapara dhe të realizuara në objektivat e Planit të vitit 2012. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), gjatë këtyre dy proceseve zgjedhore ka dëshmuar se është organ apolitik, i pavarur, i vendosur dhe i aftë në zgjidhjen e rasteve të ndryshme për Zgjedhje të Jashtëzakonshme për kryetar komune në Ferizaj të mbajtura më datë 29.04.2012 dhe për Zgjedhje të Jashtëzakonshme për kryetar komune në Kaçanik të mbajtura më datë 17.06.2012. PZAP-i, të gjitha ankesat dhe apelet e lejuara të parashtruara nga palët e interesuar për proceset zgjedhore të sipërshënuara i ka vendosur duke u bazuar në LZP, Rregullat Zgjedhore, Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, në afatet e parapara ligjore me çka Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), i ka mundësuar shpalljen e rezultateve përfundimtare dhe certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Efikasiteti dhe efektiviteti i Institucionit të PZAP-it i treguar në këto dy procese zgjedhore të cekura më lartë si dhe në proceset zgjedhore të më hershme ka treguar dhe po tregon se performanca e këtij Institucioni është bërë e njohur për publikun dhe Institucionet e vendit. Ngritja e performancës në kuptimin kualitativ e ka rritur besimin e publikut.

4 AKT EMËRIMET E SHËRBYESVE CIVIL DHE VLERËSIMET E PUNËS PËR PERSONELIN E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT

Me qenë se, PZAP-i, për vitin 2012 nuk ka pasur vende të lira për rekrutimin e stafit për arsye se të gjitha vendet e lejuara me buxhet i ka të plotësuar, në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13 maj 2010 dhe akteve nënligjore të nxjerrura në pajtim me këtë ligj, i ka lëshuar akt emërimet e karrierës pa afat për të gjithë shërbyesit civil nga niveli me i ulët deri të niveli me i lartë si dhe është bërë vlerësimi i punës dhe performanca të zyrtarëve të sekretariatit të PZAP-it për vitin 2012.

4.1 Miratimi i rregullores Për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP

Në pajtim me Rregulloren Nr. 09/2012 Për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, PZAP-i, ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të punës për institucionin tij dhe në afatin e paraparë ligjorë e ka dorëzuar në Ministrinë e Administratës Publike për procedurë të mëtejme.

4.2 Miratimi i Rregullës Nr. 01/2012 Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në bazë të nenit 115 të Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr. 03 / L-072) ka nxjerrë këtë Rregull me qëllim të lehtësimit të punës së tij për shqiptimin e sanksioneve dhe gjobave gjatë procesit zgjedhor në të ardhmen.

4.3 Zyra Ligjore

Aktivitetet e Zyrarëve të Zyrës Ligjore kanë qene si në vijim:

- Aktiviteti lidhur me Mësimet e nxjerra nga zgjedhjet e kaluara, mangësitë dhe përparësitë e LZP-së dhe rregullave tjera zgjedhore;
- Rekomandimet për ndryshimin e disa neneve të LZP-së; Rekomandimet lidhur me statusin e PZAP-it për GPZ;
- Përgatitja e një draft rregulloreje për skemën e gjobave;
- Veprime administrative lidhur me hetimin e rasteve të ndryshme për zgjedhjet për kryetar të komunave në Ferizaj dhe Kaçanik;
- Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës sa i përket progresit të hetimeve për parregullsitë gjatë proceseve zgjedhore për kryetar të komunave në Ferizaj dhe Kaçanik;
- Bashkëpunimi me Prokurorin e Shtetit lidhur me dorëzimin e rasteve që kanë elemente të veprës penale në bazë të KPK, për zgjedhjet për kryetar të komunave në Ferizaj dhe Kaçanik dhe
- Përgatitja e shkresave të ndryshme për Gjykata të ndryshme nëpër Kosovë për rastet që janë në procedurë.

Kthimi i përgjigjeve në kërkesat e parashtruar nga gjykatat e ndryshme komunale nëpër Kosovë për rastet që janë në procedurë lidhur me zgjedhjet e kaluara, Bashkëpunimi në vazhdimësi PZAP-it me Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror Zgjedhor – KQZ-së, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërlidhura të përcaktuara me LZP, siç janë periudha e sfidimit, konfirmimi i certifikimit të subjekteve politike për pjesëmarrje në zgjedhje, ankesat që ZRPPC i adreson PZAP-it për mos deklarimin e raportit financiar nga ana e subjekteve politike etj, Kategorizimi i ankesave dhe vendimeve të ndryshme nga zgjedhjet 2010/2011.

5 PËRKTHIMI I DOKUMENTEVE DHE QASJA NË INFORMATAT ZYRTARE

PZAP-i, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve të gjitha vendimet dhe dokumentet tjera zyrtare i ka përkthyer në gjuhët zyrtare.

Gjatë vitit 2012, zyra për koordinimin e përkthimeve ka përkthyer nga gjuha shqipe në atë serbe këto dokumente:

Vendimet e ndryshme të PZAP-it për Zgjedhjet të Jashtëzakonshme në Ferizaj dhe Kaçanik – 100 vendime, paralajmërimet e PZAP-it për Subjektet Politike lidhur me mospagimin e gjobave – 15 shkresa, Raportin Vjetor të PZAP-it për vitin 2011, Raporti Financiar me të gjitha pjesë të tij për vitin 2012, Raportet tremujore të Buxhetit të PZAP-it për vitin 2012, Kërkesat Buxhetore, Njoftimet për ëeb faqe zyrtare të PZAP-it,

Rregullorja e PZAP-it për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave dhe agjenda dhe shkresa të ndryshme për takime.

PZAP-i, ka adresën zyrtare dhe mirëmban faqen zyrtare të tij ku të gjithë të interesuarit kanë mundësi të kenë qasje në informatat e Institucionit si për mënyrën e organizimit të institucionit, Legjislacionin e PZAP-it, vendimet e publikuara në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, raportet vjetore, komunikata si dhe shkresat tjera.

6 KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-it

Në bazë të ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, PZAP-i, me qëllim të ushtrimit të funksionit dhe përgjegjësisë të tij ka të formuara disa komisione të Përhershme siç janë:

- 1 Komisioni për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pese) anëtarëve të panelit,
- 2 Komisioni për Buxhet dhe Personel i përberë prej 5 (pese) anëtarëve të panelit,
- 3 Komisioni Disiplinor i përberë prej Zyrtareve të Lartë të Sekretariatit,

4 Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përberë prej Zyrtareve të Lartë të Sekretariatit.

Komisioni për Çështje Ligjore është komision i përhershme i cili përbehen nga anëtarët e PZAP-it të cilat në mënyrë të përhershme merren me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me fushën e kompetencave dhe të mandatit të Institucionit të PZAP-it, të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Lokale në Republikën e Kosovës dhe amendamentimin e Rregullave dhe Procedurave të brendshme të PZAP-it.

Ky komision në punëtorit dhe takimet e mbajtura ka dhënë kontributin dhe ekspertizën profesionale lidhur me reformën zgjedhore sa i përket mandatit të PZAP-it të përcaktuar me ligj, nxjerrjen dhe miratimin e Rregullës Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave.

Komisioni për Buxhet është komision i përhershme i cili përbehen nga anëtarët e PZAP-it të cilat në mënyrë të përhershme merren me çështjet e buxhetit dhe të personelit të PZAP-it.

Ky komision në punëtorit dhe takimet e mbajtura ka dhënë kontributin dhe ekspertizën profesionale në çështjet e buxhetit dhe personelit të sekretariatit si janë struktura organizative e sekretariatit, nxjerrjen dhe miratimi i Rregullores për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP etj.

Ndërsa komisionet nën nr. rendor 3 dhe 4 janë komisione të përhershme të cilat merren me çështjet e procedurave disiplinore dhe të ankesave të personelit të administratës së Sekretariatit, respektivisht me çështjet e marrëdhënies së punës të shërbyesve civil të sekretariatit.

6.1 Komisionet përkohshme të PZAP-it

Komisioni për Inventarizimin e Pasurisë, Komisioni për Vlerësimin e Pasurisë dhe Komisionet tjera të përkohshme, kanë për qëllim menaxhimin dhe vlerësimin e pasurisë së PZAP-it, në pajtim me aktet nënligjore të Qeverisë.

7 PUNËTORIT E PZAP-IT TË MBAJTURA NË VITIN 2012

Punëtorja e mbajtur në Durrës nga data 19 – 22 mars 2012 të cilin e ka organizuar PZAP-i.

Në këtë takim janë diskutuar çështjet të ndryshme siç janë:

- Mësimet e Nxjerra nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2010/2011;
- Rekomandimet e PZAP-it adresuar Grupin Punues për Reformën Zgjedhore;
- Koordinimi i PZAP-it me Institucionet tjera siç janë: Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, KQZ-ja etj, gjatë proceseve Zgjedhore dhe lidhur me procesin zgjedhor;
- Korniza Ligjore, boshllëku apo te metat e kësaj kornize që janë vërejtur gjatë procesit Zgjedhor 2010/2011;
- Prezantimi i raportit për zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare 2010/211 dhe
- Prezantimi i raportit vjetorë të PZAP-it.

Punëtorja e mbajtur në Durrës nga data 10 – 13 tetor 2012 të cilin e ka organizuar PZAP-i.

Në këtë punëtori është diskutuar për nxjerrjen e një rregulloreje për gjoba ndaj subjekteve politike duke u bazuar në LZP.

7.1 Pjesëmarrja e anëtareve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit të PZAP-it në vizita dhe grupe punuese në vend dhe jashtë vendit.

Anëtarët dhe Personeli i Sekretariatit të PZAP-it me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të Institucionit dhe performancës së tij kanë marrë pjesë brenda dhe jashtë vendit në vizita studimore, trajnime dhe seminare të ndryshme.

7.2 Vizita në Finlandë

Kryetari i PZAP-it, ka marr pjesë në vizitë në Finlandë më Grupin Punues për Reformë Zgjedhore, për vëzhgimin e zgjedhjeve Presidenciale. Kjo vizitë është organizuar nga OSCE-ja nga data 03.02.2012 deri më 06.02.2012, por te gjitha shpenzimet e vizitës i ka hequr PZAP-i.

7.3 Vizita në Austri

Kryetari i PZAP-it, ka marr pjesë në vizitë në Austri më Komisionin Kushtetues për Reformë Zgjedhore nga data 16.04.2012 deri më 19.04.2012. Shpenzimet e vizitës i ka hequr PZAP-i.

Stafi i sekretariatit përfshirë këtu edhe Kryesuesin e tij, kanë marrë pjesë në disa trajnime brenda dhe jashtë vendit ne të cilat trajnime janë trajtuar temat si ne vijim: Procesi i Planifikimit, Ekzekutimit dhe Auditimit të Buxhetit, Komunikimi Efektiv në

Institucione, Zbatimi i Ligjit të punës në Praktik, Prokurimit Publik, Niveli Themelor, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore etj.

8 SHPENZIMEVE VJETORE PER VITIN FISKAL-2012

8.1 Ndarjet Buxhetore

PZAP-i, është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0170 i cili financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2012 përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë (LMFPP - 03/L-48), Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK), të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimi të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€).

Shumat raportuese janë në njësi në €.

8.2 Buxheti i Planifikuar për Vitin - 2012

Për vitin 2012 për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndarë buxhet në shumë prej 268,986.00€.


8.3 Buxheti i aprovuar i PZAP-2012

Përshkrimi	Buxheti i aprovuar 2012	Total Buxheti
Paga dhe mëditje	160,184.00	160,184.00
Mallra dhe shërbime	99,602.00	99,602.00
Shërbime Komunale	9,200.00	9,200.00
Total	268,986.00	268,986.00

8.4 Struktura e buxhetit për vitin 2012

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it ne shume prej 268,986.00 € si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre:

- 59.55 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 37 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 3.4% për shpenzimet komunale.



8.5 Buxheti i shpenzuar për vitin 2012

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2012, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it për vitin 2012 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket në vijim:

Buxheti i Shpenzuar -2012

Kategoritë Ekonomike	Total buxheti i Aprovuar	Buxheti i shpenzuar	Përqindja (%)
Paga dhe mëditje	160,184.00	125,901.52	78.60%
Mallra dhe shërbime	99,602.00	53,921.76	54.13%
Shërbime Komunale	9,200.00	7,920.04	86.10%
Total:	268,986.00	187,743.32	69.80%

a. Paga dhe mëditjet

Për vitin 2012 për Kategorinë se Pagave dhe Mëditjeve janë planifikuar mjete në vlerë prej

160,184.00€. Janë realizuar 125,901.52€ apo buxheti është shpenzuar 78.60%.

Dallimi në mes të Planifikimit dhe realizimit të Buxhetit është se të gjithë anëtarët e Panelit

pagën në PZAP e marrin si pagë sekondare ndërsa PZAP-i është i detyruar të planifikoj pagën e plotë me Buxhetin e vitit kalendarik në bazë të Vendimit të Qeverisë, andaj këtu na del një ndryshim në mes Buxhetit të Planifikuar dhe të Realizuar sa i përket kategorisë se Pagave dhe Mëditjeve.

b. Mallra dhe shërbime

Për vitin 2012, janë planifikuar mjete në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 99,602.00€ . Këto mjete u shpenzuan në shumë prej 53,921.76€ apo buxheti është shpenzuar 54.13% . Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:

- Modullit të aprovimeve dhe
- Modullit të blerjeve-prokurimit.

Me poshtë janë të prezantuara shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2011. Vlen të theksohet se sa i përket kategorisë së Mallrave dhe Shërbimeve me Vendim të Qeveris Nr. 04/101 të datës 14.11.2012 për Reduktimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2012 janë bërë kursime buxhetore nga të gjitha Organizatat Buxhetore, ku

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka kursyer nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 10,000.

Mallra dhe shërbime

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2012
Mallra dhe Shërbime	53,921.76
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	16,512.50
Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit	1,635.60
Shërbimet tjera telefonike vala 900	8,640.00
Shërbimet kontraktuese tjera	1,890.00
Shërbime të ndryshme shëndetësore	15.00
Harduer për teknologji informative < 1000	4,609.84
Furnizimi për Zyre	9,298.31
Shërbime teknike	80.00
Karburant për vetura	4,631.10
Shërbimet postare	7.65
Regjistrimi, sigurimi i automjeteve	1,011.59
Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve	924.33
Mirëmbajtja e ndërtesave	870.00
Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	174.00
Shpenzimet për informim publik	733.16
Pajisje trafiku	947.40
Drekat zyrtare	1,941.28

c. Shpenzimet komunale


Buxheti i aprovuar i shpenzimeve komunale për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është ne shumë prej 9,200.00€. Krahasuar me buxhetin e planifikuar shpenzimet u realizuan 86.10%, çka do të thotë se buxheti është shpenzuar 7,920.04€.

8.6 Pjesa përmbyllse e raportit të shpenzimeve

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe data bazës të Sekretariatit të PZAP-it mund të përfundojmë se për vitin 2012 Buxheti u shpenzua **187,743.32€**. Pjesë përmbyllëse e

këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2012.

Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuar të PZAP-it për vitin 2012



8.7 Te Hyrat e PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP-i)) ne bazë të nenit 120 paragrafi 1. pika c. të Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Ferizaj dhe në Kaçanik të mbajtura në vitin 2012, ka vendosur gjyba ndaj subjekteve politike në shumë prej 43,950.00 euro.

Të Hyrat e realizuara për vitin 2012

Nr.	Nr. Vendimi i PZAP-it	Subjekti politik	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	Anr.56/2012	AAK	1,500.00	1,500.00	00
2	Anr.57/2012	LDK	2,000.00	2,000.00	00
3	Anr.58/2012	LDK	2,050.00	2,050.00	00
4	Anr.59/2012	PDK	2,000.00	2,000.00	00
5	Anr.62/2012	LVV	1,700.00	1,700.00	00
6	Anr.63/2012	LDK	2,100.00	2,100.00	00
7	Anr.64/2012	LDK	2,150.00	2,150.00	00
8	Anr.71/2012	AKR	2,000.00	2,000.00	00
9	Anr.72/2012	PDK	2,050.00	2,050.00	00
10	Anr.74/2012	LDK	2,200.00	2,200.00	00
11	Anr.75/2012	PDK	2,100.00	2,100.00	00
12	Anr.87/2012	PDK	2,150.00	2,150.00	00
13	Anr.90/2012	AAK	1,600.00	1,600.00	00
14	Anr.119/2012	PDK	2,200.00	2,200.00	00
15	Anr.152/2012	LDK	1,000.00	00	1,000.00
16	Anr.172/2012	LDK	2,000.00	00	2,000.00
17	Anr.177/2012	PDK	2,000.00	00	2,000.00
18	Anr.196/2012	PDK	2,500.00	00	2,500.00
19	Anr.195/2012	PDK	2,600.00	00	2,600.00
20	Anr.169/2012	AAK	2,000.00	00	2,000.00
21	Anr.180/2012	AAK	2,050.00	00	2,050.00
22	Anr.181/2012	LVV	2,000.00	2,000.00	00
Gjithsejtë:			43,950.00	29,800.00	14,150.00

Në tabelën me lartë në kolona janë të shënuara të dhënat për Numrin e vendimit, emrin e subjekteve politike, shumën e gjobave të shqiptuara, pagesën e gjobave të shqiptuara dhe gjobat e pa paguara.

Nga totali i shumës 43,800.00€ te gjobave të shqiptuara gjatë vitit 2012 për Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Ferizaj dhe në Kaçanik në mënyrë të rregullt, gjobat i ka paguar vetëm LVV, ndërsa në bazë të nenit 18 të Ligjit Nr. 03/L-174 Për Financimin e Subjekteve Politike, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, (AAK-së) për mospagimin e detyrimeve, respektivisht gjobave ndaj PZAP-it, KQZ-ja u ka zbritur buxhetin nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike të ndarë për vitin 2012 dhe njëherësh buxhetin e zbritur - ndalur e ka transferuar - bartur përmes thesarit në fondin e te hyrave të PZAP-it, respektivisht në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Realizimi, mbledhja e këtyre të hyrave është arritur falë bashkëpunimit shumë të mirë Institucional në mes të KQZ-së dhe PZAP- it.

Subjektet Politike, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për Zgjedhjet e jashtëzakonshme në komunën e Kaçanikut ende nuk i kanë paguar gjobat e shqiptuara gjatë këtyre zgjedhjeve PDK-ja ka borxh 7,100.00€, LDK-ja 3,000.00€ dhe AAK-ja 4,050.00€).

PZAP-i, deri me tani për vitin 2012 nga shumat e gjobave të shqiptuara ndaj subjekteve politike prej 43,950.00 euro, ka mbledhur 29,800.00 euro që do të thotë se ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

9 AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR VITIN 2012

PZAP-i me qëllim të lehtësimit dhe funksionimit të tij në përmbushjen e mandatit të përcaktuar me ligj në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik ka zhvilluar disa aktivitetet te prokurimit:

- Ka lidhur marrëveshje afatgjate trevjeçare për Mirëmbajtjen e Web faqes së PZAP-it;
- Ka lidhur marrëveshje afatgjate trevjeçare për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave te punës ne PZAP;

Ka lidhur marrëveshje afatgjate trevjeçare për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve.

10 BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Institucioni i PZAP-i si edhe ne te kaluarën edhe gjatë viti 2012, ka pasur dhe vazhdon të këtë bashkëpunimin të mirë me institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, që shpresojmë dhe besojmë se këtë bashkëpunim për arsye te natyrës se punëve dhe mandatit të PZAP-it të përcaktuar me ligj do të vazhdojmë ta ushtrojmë dhe ta kultivojmë edhe ne të ardhmen.

Bashkëpunimi i PZAP-it me Komisionin Qendror Zgjedhor - KQZ

- Bashkëpunimi i PZAP-it me KQZ-në është i bazuar ne Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës (LZP). Ky bashkëpunim është i përhershëm i arsyeshëm, i nevojshëm dhe i detyrueshëm para, gjatë dhe pas proceseve zgjedhore.
- PZAP-i me Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të KQZ-së, ka bashkëpunuar ngushtë prej fillimit e deri ne përfundimin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj dhe Kaçanik, dhe atë sa i përket periudhës se sfidimit, konfirmimi i certifikimit te subjekteve politike për pjesëmarrje ne zgjedhje, ankesat qe ZRPPC i adreson PZAP-it për mos deklarimin e raportit financiar nga ana e subjekteve politike etj., sidomos për parregullsitë gjatë numërimit në ditën e votimit si dhe për parregullsitë që shkaktohen në Qendrën e Numërimit te Rezultateve - QNR.

Bashkëpunim i PZAP-it me Policinë e Kosovës

- Bashkëpunimi i PZAP-it me Policinë e Kosovës ka qene prej fillimit e deri në përfundimin e procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj dhe Kaçanik sa i përket progresit te hetimeve për parregullsitë gjatë procesit zgjedhor dhe sigurisë së procesit zgjedhor.

Bashkëpunimi i PZAP-it me Gjykatën Supreme të Kosovës

- Bashkëpunimi i PZAP-it me Gjykatën Supreme të Kosovës ka qene lidhur me apelimin e vendimeve te PZAP-it për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj dhe Kaçanik.

Bashkëpunimi i PZAP-it me Prokurorinë e Shtetit

- Bashkëpunimi i PZAP-it me Prokurorin e Shtetit ka qene lidhur me dorëzimin e rasteve që kanë elemente të veprës penale në bazë te KPK për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj dhe Kaçanik

Bashkëpunim i PZAP-it me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian - OSBE

- PZAP-i më OSBE-n ka bashkëpunuar shumë ngushtë gjatë gjithë vitit e me se shumti ky bashkëpunim ka qene gjatë proceseve zgjedhore për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj dhe Kaçanik. PZAP-i me Zyrtaret e Departamentit për zgjedhje të OSBE-së ka takime të rregullta javore ne te cilat takime bisedohet dhe trajtohen çështje aktuale me interes për PZAP-in. Përkrahja dhe bashkëpunimi i OSBE-së ndaj PZAP-it ka qene ne mënyrë të veçantë ne dhënien e këshillave gjatë procesit te përgatitjes se rekomandimeve për Reformën Zgjedhore sa i përket mandatit te PZAP-it dhe bashkëpunim ne hartimin e legjislacionit sekondar, si dhe ne çështje tjera me interes për Institucionin e PZAP-it.

11 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE STATISTIKA PËR ZGJEHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR KOMUNE NË FERIZAJ DHE NË KAÇANIK

PZAP-i, me njëherë pas shpalljes zyrtare të ditës së zgjedhjeve, respektivisht caktimit të datës së zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizajt dhe Kaçanik, ka filluar zbatimin e planit të punës për këto dy procese zgjedhore.

PZAP-i, ka organizuar kujdestarin për këtë proces të Jashtëzakonshëm Zgjedhor, respektivisht ka caktuar orarin e punës shtesë për stafin për pranimin e ankesave, procedimin dhe vendosjen e tyre nga ana e Panelit prej fillimit të procesit zgjedhor e deri ne përfundimin e tij, respektivisht deri ne certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve.

Ka mbajtur takime dhe kontakte të rregullta me personin kontaktues të Policisë së Kosovës lidhur me progresin e hetimeve për parregullsitë e pretenduara nga ana e subjekteve politike dhe nga palët e interesuara, gjatë gjithë procesit zgjedhor. Përgatitja e Formularëve të ankesave në gjuhët zyrtare të Kosovës, shtypja e numrit të mjaftueshëm të këtyre formularëve dhe shpërndarja tyre nëpër të gjitha Qendrat e Votimit (QV).

Konfirmimi i kompletimit të procesit të certifikimit të subjekteve politike dhe pritja e ankesave dhe vendosja e tyre lidhur me certifikimin e subjekteve politike.

Pritja e ankesave dhe vendosja e tyre nga ana e panelit për fillimin e fushatës para datës së caktuar për fillimin zyrtar të fushatës zgjedhore, gjatë kohës së heshtjes zgjedhore, për ditën e zgjedhjeve, ankesat që kanë të bëjnë me Qendrën e Numërimit të Rezultateve të Zgjedhjeve – QNR.

Konfirmimin për Komisionin Qendror Zgjedhor – KQZ-n për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), gjatë procesit të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar komune në Ferizaj dhe në Kaçanik, ka kryer me sukses funksionet dhe përgjegjësit e tij të përcaktuar me ligj, ku për proceset zgjedhore të përmendura me lartë në afatin e paraparë ligjor ka vendosur 120 ankesa, të cilat kanë qenë brenda juridiksionit të PZAP-it, prej këtyre ankesave; 21 % janë miratuar, 79 % janë refuzuar, janë hedhur poshtë si të pasafatshme, të parakohshme apo PZAP-i është

shpall inkompetent. Vendosja e te gjitha ankesave nga PZAP-i, në afatin e paraparë ligjor i ka mundësuar, Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), certifikimin e rezultateve të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar komune në Ferizaj dhe në Kaçanik.

PZAP-i, brenda juridiksionit të tij, ka shqiptuar gjoba ndaj subjekteve politike në shumë prej 43,950.00 euro dhe një personi i ka shqiptuar masën administrative ndalimin e pjesëmarrjes për 2 (dy) vite në zgjedhjet e ardhshme si kandidat apo si pjesë e stafit administrativ që menaxhohet nga KQZ-ja.

12 NATYRA E ANKESAVE TË PARAQITURA NË PZAP GJATË PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR NË KOMUNËN E FERIZAJT

Për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Ferizaj, në rundin e parë të zgjedhjeve në PZAP janë paraqitur ankesa të natyrave të ndryshme siç janë:

1. Për fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar zyrtare për fushatë zgjedhore, numri i ankesave të kësaj natyre është 14 (katërbëdhjetë). Këto ankesa janë parashtruar në PZAP nga subjektet politike për shkak se disa subjekte politike i kanë vendosur posterat me përmbajtje garues në zgjedhje para datës së caktuar për fushatën zgjedhore. Subjektet politike të cilat i kanë parashtruar ankesat në PZAP për Fillimin e Fushatës Zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore janë: Partia demokratike e Kosovës (PDK) i ka parashtruar 9 (nëntë) ankesa të kësaj natyre dhe Lëvizja vetëvendosja i ka parashtruar 5 (pesë) ankesa të kësaj natyre.
2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore janë parashtruar në PZAP 19 (nëntëmbëdhjetë) ankesa dhe atë si në vijim:
 - Vendosja e posterave në rrugë publike, numri i ankesave të kësaj natyre është 6 (gjashtë);
 - Vendosja e posterave në objekte publike, numri i ankesave të kësaj natyre është 4 (katër);
 - Vendosja e posterave në shenja të komunikacionit, numri i ankesave të kësaj natyre është 2 (dy);
 - Mbulimi i posterave, numri i ankesave të kësaj natyre është 8 (tetë);

3. Gjatë ditës së heshtjes zgjedhore: Për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, numri i ankesave të parashtruara në PZAP të kësaj natyre është 10 (dhjetë). Këto ankesa janë parashtruar në PZAP nga subjektet politike dhe nga Rrjeti Ballkanik i gazetarisë Hulumtuese (BIRNI). Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) i ka parashtruar 2 (dy) ankesa, për bërjen e fushatës zgjedhore në ditën e zgjedhjeve, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar 1 (një) ankesë të kësaj natyre për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore para votuesve në ditën e votimit si dhe BIRNI i ka parashtruar në PZAP 7 (shtatë) ankesa për thyerjen e heshtjes zgjedhore duke postuar fotografi të kandidatit me përmbajtje garuese në zgjedhje në facebook.
4. Për shkak të Akreditimit të vëzhguesve në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), janë 1 (një) ankesë të kësaj natyre. Më këtë ankesë është pretenduar se janë akredituar numër i madh vëzhguesve që është në kundërshtim me LZP.
5. Gjatë ditës së zgjedhjeve (ditës së votimit) janë paraqitur 39 ankesa për shkak të:
 - Mungesës së Librit për identifikimin e votuesve, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
 - Mungesës së fletëvotimeve ngase ka pas më pak fletëvotime sesa votues, numri i ankesave të kësaj natyre është 6 (gjashtë);
 - Vendorsjes së posterave më përmbajtje garuese më afër se 100 metra nga Qendra e Votimit (QV) në ditën e votimit, numri i ankesave të kësaj natyre është 8 (tetë);
 - Për shkak se një person i një subjekti politik ka bartur votues me veturë zyrtare, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
 - Për shkak të ndërrimit të Qendrës së Votimit (QV), numri i ankesave të kësaj natyre është 2 (dy);
 - Për shkak të tentimit për të votuar dy herë në zgjedhje të njëjta, numri i ankesave të kësaj natyre është 3 (tri);
 - Për shkak të Votimit në emër të dikujt tjetër, numri i ankesave të kësaj natyre është 2 (dy);
 - Për shkak se Menaxheri i QV-së ka kërkuar ti kontrolloi anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;

- Për shkak të Votimit Familjar, numri i ankesave të kësaj natyre është 2 (dy);
- Për shkak se Komisioni Komunal Zgjedhor në Ferizaj e ka lejuar një person me votuar me vërtetimin e lëshuar nga komisioni i lartcekur, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
- Për shkak të Falsifikimit të Bexhit, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
- Për shkak të votimit nën moshën 18 vjet, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
- Për shkak se në QV kanë hyrë disa persona pa autorizim, numri i ankesave kësaj natyre 2 (dy);
- Për shkak se në Zilen e Telefonit Mobil të një anëtarit të KVV-së, ka qenë një fjalim i mbajtur i kryeministrit të Republikës së Kosovës, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
- Për shkak se brenda në Vendvotim kanë pirë cigare, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
- Për shkak se Menaxheri i QV-së, ka bërë presion për të votuar subjektin e caktuar politik, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
- Për shkak të kërcënimit ndaj votuesve, numri i ankesave kësaj natyre 4 (katër) dhe
- Për shkak të Ofendimit ndaj anëtarëve të KVV-së , është 1 (një) ankesë e kësaj natyre.

Ndërsa për raundin e dytë të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune të Ferizajt, natyra e ankesave të paraqitura në PZAP, janë si në vijmë:


- Për shkak të fyerjes gjatë procesit të votimit, 1 ankesë;
- Për shkak të pengimit gjatë procesit të votimit, 1 ankesë;
- Për shkak të falsifikimit të bexhit, 1 ankesë;
- Për shkak të mos vulosjes së fletëvotimeve më qëllim që të shpallen të pavlefshme, 1 ankesë;
- Për shkak të mos numërimit të votave nëpër Qendrat të Votimit Mobil, 1 ankesë dhe
- Për shkak të mos hapjes së Zarfeve për ti numëruar Fletëvotimet, 1 ankesë.

PZAP-i, gjatë procesit zgjedhor në Ferizaj për raundin e parë të zgjedhjeve ka marr vendime të ndryshme dhe atë si më poshtë:

- PZAP-i, ka vendosur si të bazuara, 15 (pesëmbëdhjetë) ankesa, për këto 15 ankesa, PZAP-i, ka marr 14 (katërmbëdhjetë) vendime me gjoba sepse në një rast ka qenë natyra dhe vendi i njëjtë i shkeljes së supozuar, mirëpo ankesat janë parashtruar në PZAP prej Subjekteve politike (palëve) të ndryshme;
- PZAP-i, ka vendosur si të bazuar 1 (një) ankesë me të cilin vendim një (1) personi i është ndaluar për tri (3) vite që të marr pjesë si kandidat dhe si pjesë e stafit administrativ të menaxhuar nga KQZ-ja;
- PZAP-i, ka vendosur si të pabazuara, 50 (pesëdhjetë) ankesa;
- PZAP-i, ka vendosur si të palejuara, 15 (pesëmbëdhjetë) ankesa;
- PZAP-i, është shpallur inkompetent për 2 (dy) ankesa;
- PZAP-i, ka miratuar 1 (një) kërkesë më të cilën pala ka kërkuar që ta tërheq ankesën e parashtruar. Një subjekt politik pasi ka parashtruar ankesë për mbulim të posterave ka kërkuar që të tërhiqet ankesa dhe mos të shqyrtohet nga paneli.


Ndërsa për raundin e dytë të zgjedhjeve në Ferizaj PZAP-i ka marr këto lloje të vendimeve:

- PZAP-i, për një ankesë, ka vendosur një vendim me dy pjesë të dispozitivit në të cilin vendim është gjobitur subjekti politik dhe një personi i është ndaluar për 3 (tri) vite pjesëmarrja në zgjedhjet e ardhshme si kandidat apo si pjesë e stafit administrativ në zgjedhje të menaxhuara nga KQZ-ja ;
- PZAP-i ka vendosur si të bazuar një ankesë më të cilin vendim një personi i është ndaluar për 3 (tre) muaj pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si pjesë e stafit administrativ në zgjedhje të menaxhuara nga KQZ-ja,
- PZAP-i, ka vendosur si të pabazuara 4 (katër) ankesa,
- PZAP-i, për 1 (një) ankesë është shpallur inkompetent dhe çështjen e ka proceduar në Prokurorin Shtetërore për procedim të mëtejshëm.




Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur ankesat e parashtruara në PZAP sipas subjekteve politike gjatë procesit zgjedhor për kryetar komune në Ferizaj:

Nr.	Subjekti politik	Nr. I ankesave
1	Lëvizja Vetëvendosja (VV)	34
2	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	23
3	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	21
4	Rrjeti Ballkanik I Gazetarisë Hulumtuese (BIRN)	12
5	Këshillat e Vendvotimeve (KVV)	1
Totali		91



Numri i ankesave të parashtruara në PZAP nëpër secilën fazë të procesit zgjedhor për kryetar në komunën e Ferizajt:

Nr.	Ankesat e parashtruar në PZAP sipas fazave të procesit zgjedhor në Ferizaj	Nr. i ankesave
1	Ankesat e parashtruara për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore	13
2	Ankesat e parashtruara gjatë periudhës së fushatës zgjedhore	22
3	Ankesat e parashtruar për thyerjen e heshtjes zgjedhore	15
4	Ankesat e parashtruar për ditën e votimit	41
Totali:		91



12.1 Rastet e dorëzuara në Prokurorinë e Shtetit

PZAP-i, gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga palët e interesuar dhe vendosjes se tyre ka identifikuar disa ankesa në të cilat ka pasur pretendime ankimore me përmbajtje dhe elemente të veprës penale.


Të gjitha këto raste të identifikuar i ka dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës, prej tyre 7 (shtatë) raste i ka dorëzuar për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të komunës në Ferizaj dhe 1 (një) rast për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të komunës në Kaçanik.


12.2 Paditë e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme

Me rastin e shqyrtimit të ankesave dhe vendosjes së tyre lidhur me pretendimet ankimore të palëve të interesuara, palët e pa kënaqura kanë shfrytëzuar dhe ushtruar të drejtën e dy shkallëshmërisë dhe vendimet e PZAP-it i kanë apeluar në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës. Për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës në Ferizaj, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës për mes padisë është apeluar 1 (një) vendim i PZAP-it e cila padi është refuzuar dhe është vërtetuar vendimi i shkallës së parë, respektivisht është vërtetuar vendimi i PZAP-it.

12.3 SANKSIONET: Gjocat shqiptuara ndaj Subjekteve Politike për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në Ferizaj

Nr	Subjekti politik (SP)	Nr. Ankesave që kanë rezultuar me gjoca ndaj SP	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	LDK	6	11,500.00	10,500.00	1,000.00
2	PDK	5	10,500.00	10,500.00	0.00
3	AAK	2	3,100.00	3,100.00	0.00
4	AKR	1	2,000.00	2,000.00	0.00
5	LVV	1	1,700.00	1,700.00	0.00
Gjithsejtë:		15	28,800.00	27,800.00	1,000.00





PZAP ka autoritet ligjor të marrë vendime në pretendimet se janë shkelur dispozitat e Kodit të Mirësjelljes, si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me ligj.


PZAP- i ka shqiptuar gjoba Subjekteve Politike lidhur me Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune të Ferizajt dhe atë si në vijim:

- Shuma e gjobave të shqiptuara ndaj Subjekteve Politike është gjithsejtë:
28.800.00 €
- Shuma e gjobave të paguara nga Subjektet Politike është gjithsejtë:
27.800.00 €,
- Shuma e gjobave të papaguara nga Subjektet Politike është gjithsejtë:
1.000,00 €,

13 NATYRA E ANKESAVE TË PARAQITURA NË PZAP GJATË PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR NË KOMUNËN E KAÇANIKUT


Gjatë procesit Zgjedhor të Jashtëzakonshëm për Kryetar Komune në Kaçanik, në PZAP janë paraqitur ankesa të natyra të ndryshme siç janë:

1. Për fillimin e fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, nuk ka pasur ankesa të kësaj natyre;
2. Gjatë fushatës zgjedhore janë paraqitur ankesat si në vijim:
 - Për shkak të vendosjes së posterit në apo mbi rrugët publike, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
 - Për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, numri i ankesave të kësaj natyre është 10 (dhjetë);
3. Gjatë ditës së heshtjes zgjedhore: Për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, numri i ankesave të kësaj natyre është 2 (dy).
4. Për shkak të Akreditimit të vëzhguesve në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nuk ka pasur fare ankesë të kësaj natyre;
5. Gjatë ditës së zgjedhjeve (ditës së votimit)
 - Për shkak të vendosjes së posterave më përmbajtje garuese më afër se 100 metra nga Qendra e Votimit (QV) në ditën e votimit, numri i ankesave të kësaj natyre është 2 (dy);
 - Për shkak të tentimit për të votuar dy herë në zgjedhjeve të njëjta, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
 - Për shkak të fyerjes gjatë procesit të votimit, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
 - Për shkak se një vëzhgues nuk është lejuar të shkruaj vërejtjet në Librin e Vërejtjeve, është 1 (një) ankesë e kësaj natyre;
 - Për shkak të qëndrimit disa personave në QV pa autorizim, numri i ankesave të kësaj natyre është 6 (gjashtë);
 - Për shkak se është bërë presion ndaj votuesve, për të votuar subjektin e caktuar politik, numri i ankesave të kësaj natyre është 3 (tri);
 - Për shkak të kërcënimit dhe largimit të dhunshëm nga QV-ja të disa personave, numri i ankesave të kësaj natyre është 2 (dy)
6. Ankesa që kanë të bëjnë me Qendrën e Numërimit të Rezultateve – QNR, nuk ka pasur ankesa?




Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur ankesat e parashtruara në PZAP sipas subjekteve politike gjatë procesit zgjedhor për kryetar komune në Kaçanik:

Nr.	Subjekti politik	Nr. I ankesave
1	Lëvizja Vetëvendosja (VV)	27
2	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	2
Totali:		29



Numri i ankesave të parashtruara në PZAP nëpër secilën fazë të procesit zgjedhor për kryetar në komunën e Kaçanikut:

Nr.	Ankesat e parashtruar në PZAP sipas fazave të procesit zgjedhor në Kaçanik	Nr. I ankesave
1	Ankesat e parashtruara gjatë periudhës së fushatës zgjedhore	11
2	Ankesat e parashtruar për thyerjen e heshtjes zgjedhore	4
3	Ankesat e parashtruar për ditën e votimit	14
Totali:		29



13.1 Rastet e Dorëzuara në Prokurorinë e Shtetit



Në Prokurorinë e Shtetit të Republikës së Kosovës, PZAP-i, ka dorëzuar 1 (një) rast që ka pasur të bëjë me përgjegjësit individuale dhe që ka përmbajtur elemente të veprës penale të shkaktuar gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut dhe që është në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës (KPK).

13.2 Padit e Paraqitura ndaj Vendimeve te PZAP-it në Gjykatën Supreme

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, lidhur me Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune të Kaçanikut ndaj vendimeve te PZAP-it, janë parashtruar 2 padi, të cilat janë refuzuar nga Gjykata Supreme.

13.3 SANKSIONET: Gjodat shqiptuara ndaj Subjekteve Politike

Nr.	Subjekti politik (SP)	Nr. Ankesave qe kanë rezultuar me gjoda ndaj SP	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	PDK	3	7,100.00	0.00	7,100.00
2	AAK	3	4,050.00	0.00	4,050.00
3	LDK	1	2,000.00	0.00	2,000.00
4	LVV	1	2,000.00	2,000.00	0.00
Gjithsejtë		8	15,150.00	2,000.00	13,150.00



PZAP- i, ka shqiptuar gjoda Subjekteve Politike për zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut dhe atë si në vijim:

- Shuma e gjobave të shqiptuara ndaj Subjekteve Politike është gjithsejtë: **15.150.00 €**,

- Shuma e gjobave të paguara nga Subjektet Politike është gjithsejtë:
2.000.00 €,
- Shuma e gjobave të papaguara nga Subjektet Politike është gjithsejtë:
13.150.00 €.

Subjektet Politike shumat e gjobave i paguajnë në llogari të Buxhetit të Republikës së Kosovës në Xhironlogarinë : 1000400070003381.

14 Komunikimi i PZAP-it me Gjykata te ndryshme në për Kosovë gjatë vitit 2012

Në tabelën e mëposhtme gjenden: kërkesat, thirrjet, dhe njoftimet nga Gjykatat/Prokuroritë Komunale drejtuar PZAP-it, për të kërkuar materiale shtesë lidhur më rastet të cilat janë në procedurë në Prokurori dhe në Gjykata. Po ashtu më kërkesat e mëposhtme është kërkuar nga gjykatat që në seanca të caktuar të merr pjesë një përfaqësues i PZAP-it.

Nr.	Nr. i protokollit	Kërkesat, thirrjet dhe njoftimet	Gjykata/Prokurorit Komunale
1	246/2012	Kërkesë për informatë lidhur me rastin 88/11	Gjykata Komunale në Istog
2	239/2012	Kërkesë për lëndën 86/11	Gjykata Komunale në Istog
3	238/2012	Kërkesë për lëndën 87/11	Gjykata Komunale në Istog
4	237/2012	Kërkesë për lëndën 89/11	Gjykata Komunale në Istog
5	233/2012	Kërkesë për informacion	Gjykata Komunale në Kamenicë
6	31/2012	Kërkesë për dëshmi	Gjykata Komunale në Gjakovë
7	19/2012	Thirrje për shqyrtim kryesor	Gjykata Komunale në Gjiilan
8	133/2012	Thirrje për shqyrtim kryesor	Gjykata Komunale në Gjiilan
9	216/2012	Thirrje për shqyrtim kryesor	Gjykata Komunale në Kamenicë
10	250/2012	Njoftim lidhur me hedhjen e kallëzimit penal	Prokuroria Komunale në Prizren
11	251/2012	Njoftim lidhur me hedhjen e kallëzimit penal	Prokuroria Komunale në Prizren
12	214/2012	Njoftim lidhur me hedhjen e kallëzimit penal	Prokuroria Komunale në Prizren